Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

# RAPORTI VJETOR I ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS

## JANAR-DHJETOR 2019

Mars 2020, Prishtinë

# RAPORT VJETOR
# ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

Raporti vjetor i ATK-së është përgatitur bazuar në Nenin 8, paragrafi 8.2 dhe 8.3 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Neni 8 – Raportimi

1. Drejtori i Përgjithshëm do të paraqesë raporte periodike mbi veprimtarinë dhe rezultatet e ATK tek Ministri i Financave dhe Transfereve

2. Drejtori i Përgjithshëm do të përgatisë një raport vjetor mbi veprimtarinë e ATK dhe do t'i dorëzojë raportin Ministrit të Financave dhe Transfereve dhe Qeverisë së Kosovës, sipas kërkesës brenda tre (3) muajve pas përfundimit të secilit vit kalendarik.

3. Raporti vjetor i ATK do të përfshijë:

3.1. detaje mbi buxhetin e ATK;

3.2. detaje mbi numrin dhe nivelin e stafit të ATK;

3.3. detaje mbi të ardhurat e mbledhura nga ATK duke treguar hollësitë e shumave të të ardhurave për secilin lloj të tatimit dhe për secilin regjion si dhe hollësi të tjera të tilla që mund të kërkohen nga Ministri i Financave;

3.4. parashikimet e kostos së mbledhjes për secilin lloj të ardhurave nga tatimet që janë mbledhur;

3.5. detaje mbi të gjitha ndjekjet penale për vepër penale në fushën e tatimeve, kur hetimi është iniciuar nga administrata tatimore, përfshirë emrin e secilit person i cili është dënuar, dënimi i shqiptuar dhe shumën e tatimit të përfshirë; dhe

3.6. informatat në përdorimin e kompetencave të autorizuara me nenin 14 të këtij ligji, përfshirë numrin dhe natyrën e çdo ankimi rreth përdorimit të atyre kompetencave, por duke mos përmendë emrat e personave të përfshirë.

# PËRMBAJTJA


FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM ..... 7
I. HISTORIKU ..... 9
1. BUXHETI ..... 10
2. BURIMET NJERËZORE ..... 11
2.1. TRAJNIMET ..... 14
3. TË HYRAT ..... 15
3.1. TË HYRAT DHE STRUKTURA E TYRE ..... 15
3.2. TË HYRAT SIPAS MUAJVE ..... 16
3.3. TË HYRAT SIPAS LLOJEVE TË TATIMEVE ..... 17
3.4. TË HYRAT SIPAS LLOJEVE KRYESORE TË TATIMEVE ..... 18
3.5. TË HYRAT NË DTM DHE DREJTORI RAJONALE 2017-2019 ..... 19
3.6. TË HYRAT E GRUPUARA NË DTM DHE DREJTORI RAJONALE ..... 20
4. KOSTO E VLERAVE TE TRAJTUARA PËR 100 €/NJËSI ..... 20
5. TATIMI SHTESË NGA KONTROLLET SIPAS RAJONEVE ..... 21
5.1. NUMRI I KONTROLLEVE TË KRYERA NGA INSPEKTORËT TATIMOR ..... 22
6. VIZITAT PËRMBUSHËSE ..... 23
6.1. REZULTATET NGA VIZITAT PËRMBUSHËSE ..... 24
7. REGJISTRM DHE SHERBIM TË TATIMPAGUESVE ..... 25
7.1. REGJISTRIMI ..... 30
8. QENDRA E THIRRJEVE (CALL CENTER) ..... 33
9. BIZNESET E FISKALIZUARA NË DTM DHE RAJONE ..... 34
10. RIMBURSIMET DHE KTHIMET ..... 36
11. KRAHASIMI I INKASIMIT TË BORXHEVE ME PLANIN NË DTM DHE RAJONE ..... 38
12. HETIMET TATIMORE DHE INTELIGJENCA ..... 39
13. AKTIVITETET LIDHUR ME INTERPRETIMET DHE PËRFAQËSIMET LIGJORE ..... 39
14. ANKESAT E TATIMPAGUESVE ..... 42
15. KOMUNIKIM ME MEDIA DHE PUBLIKUN ..... 43
16. MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE ..... 45
17. PJESËMARRJE NË GRUPE PUNUESE ..... 48
18. SHTOJCAT ..... 50
   1. LISTA E TË PUNËSUARVE NË ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS ..... 50
   2. LISTA E PUNËTORËVE TË PENSIONUAR ..... 50
   3. LISTA E STUDENTEVE PRAKTIKANTË SIPAS MARRËVESHJES ME MINISTRINË E FINANCAVE DHE UNIVERSITETIN E PRISHTINËS 2019 (MF-UP-ATK) ..... 50
   4. LISTA E STUDENTËVE QË KANË NDJEKUR PRAKTIKËN NË ATK ..... 50
   5. VENDIMET SHPJEGUESE PUBLIKE 2019 ..... 50
   5.1. NR. 01/2019 – PËR TRAJTIMIN TATIMOR TË IMPORTEVE DHE FURNIZIMEVE KUR FINANCOHEN APO BASHKFINANCOHEN DREJTPËRDREJTË NGA KOMISIONI EVROPIAN ..... 50
   5.2. NR. 02/2019 – PËR TRAJTIMIN TATIMOR TË KONTRATAVE AFATGJATË NDËRTIMORE ..... 50
   5.3. NR. 03/2019 – DETYRIMI PËR TË PAGUAR TVSH-NË PËR FURNIZIMIN E SHËRBIMEVE NË LËMIN E NDËRTIMIT – APLIKIMI I NGARKESËS SË KUNDËRT ..... 50
   6. LIGJI NR.06/L-105 PËR TATIMIN NËTË ARDHURAT E KORPORATAVE ..... 50
   7. FLETËPALOSJE PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE(TAK) ..... 50
   8. FLETËPALOSJE PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE(TAP) ..... 50
   9. FLETËPALOSJE PËR TATIMIN MBI VLEREN E SHTUAR(TVSH) ..... 50

10. MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI 2019........................................................................................................50
11. MEMORANDUM MIRËKUPTIMI 2019........................................................................................................50
12. LISTA E BIZNESEVE QË KANË PËRFITUAR LIRIME PËR TVSH NË IMPORTIM TË LËNDËS SË PARËDHE PAJISJEVE TË TI ........................................................................................................50
13. DETAJE MBI TË GJITHA NDJEKJET PENALE PËR VEPËR PENALE NË FUSHËN E TATIMEVE NË BAZË TË LIGJIT 03/L-222, RESPEKTIVISHT NENIT 8 PARAGRAFI 8.6 ........................................................................50
14. LISTA E ANKESAVE TË TATIMPAGUESVE NË VITIN 2019 ..........................................................................50
15. LISTA E RIMBURSIMEVE PËR VITIN 2019 ......................................................................................50

# TABELAT

Tabela 1: Shpenzimet e buxhetit 2019, krahasimi me vitin 2018 dhe 2017 ........ 10
Tabela 2: Gjendja e numrit të punësuarve përfshi strukturën kualifikuese, etnike dhe gjinore ........ 12
Tabela 3: Numri i të punësuarve në ATK, viti 2019 ........ 13
Tabela 4: Numri i trajnimeve dhe pjesëmarrësve sipas institucioneve vendore dhe ndërkombëtare ........ 14
Tabela 5: numri i konferencave/punëtori ........ 14
Tabela 6: Tatimpaguesit që deklarojnë qarkullim dhe pagesa, 2017-2019 ........ 15
Tabela 7: Të hyrat e realizuara sipas muajve 2017-2019 ........ 16
Tabela 8: Të hyrat e realizuar sipas llojit të tatimeve, krahasuar me vitet paraprake ........ 17
Tabela 9: Të hyrat e realizuara sipas viteve dhe llojeve kryesore të tatimeve ........ 18
Tabela 10: Të hyrat e realizuara krahasuar me planin për DTM dhe drejtori rajonale 2017 -2019 ........ 19
Tabela 11: Të hyrat e grupuara në DTM dhe Drejtori rajonale ........ 20
Tabela 12: Kosto e vlerave për 100 €/njësi në mbledhjen e të hyrave ........ 20
Tabela 13: Tatimi shtesë 2019 nga kontrollet, krahasuar me vitet 2018 dhe 2017 ........ 21
Tabela 14: Numri i të kontrolleve te kryera 2017-2019, dhe krahasimi me periudhën e njëjtë ........ 22
Tabela 15: Vizitat përmbushëse sipas drejtorive rajonale 2017-2019 dhe krahasimi me planin 2019 ........ 23
Tabela 16: Rezultatet nga vizitat përmbushëse ........ 24
Tabela 17: Rezultatet nga gjobat për vitin 2019 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit 2018 ........ 24
Tabela 18: Aktivitetet e kryera nga shërbimi i tatimpaguesve-Zyra Qendrore ........ 28
Tabela 19: Lëshimi i vërtetimeve tatimore sipas llojeve të kërkesave ........ 29
Tabela 20: Aktivitetet e kryera nga shërbimi i tatimpaguesve-Zyrat Rajonale ........ 30
Tabela 21:Aktivitetete Rexhistrimit të t/paguesve ........ 31
Tabela 22: Deklarimet elektronike sipas muajve dhe tatimeve ........ 31
Tabela 23: Aktivitetet e realizuara nga Qendra e Thirrjeve ........ 33
Tabela 24: Raport i pagesave në DTM dhe në Drejtori rajonale nga Qendra e Thirrjeve ........ 34
Tabela 25: Gjendja e bizneseve me arka fiskale sipas drejtorive rajonale ........ 35
Tabela 26: Rimbursimet për kuponë fiskal ........ 35
Tabela 27: Rimbursimet dhe kthimet 2019 ........ 36
Tabela 28: Rimbursimet dhe kthimet sipas muajve ........ 37
Tabela 29: Krahasimi i planit dhe inkasimit të borxheve 2017-2019 ........ 38
Tabela 30: Aktivitetet e realizuara në Njësinë e Hetimeve dhe Inteligjencës ........ 39
Tabela 31: Aktivitetet e realizuara nga divizioni për Legjislacion dhe Këshilla Juridike ........ 40
Tabela 32: Aktivitetet e realizuara nga Divizioni për Përfaqësime dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional ........ 41
Tabela 33: Aktivitetet e realizuara nga Divizioni për Përfaqësime dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional ........ 42

# PARAQITJA GRAFIKE (FIGURAT)

Grafiku 1: Buxheti i shpenzuar ........ 10
Grafiku 2: Numri dhe struktura gjinore e të punësuarve........ 12
Grafiku 3: Paraqitja grafike e të hyrave të realizuara dhe kontributeve pensionale sipas viteve 2017-2019........ 16
Grafiku 4: Paraqitja grafike sipas llojeve të tatimeve ........ 17
Grafiku 5: Paraqitja grafike e të hyrave sipas viteve dhe llojeve kryesore të tatimeve ........ 18
Grafiku 6: Paraqitja grafike e të hyrave sipas drejtorive rajonale ........ 19
Grafiku 7: Vlera e tatimit shtesë 2017-2019 ........ 21
Grafiku 8: Numri i kontrolleve të kryera sipas viteve, 2017-2019 ........ 22
Grafiku 9: Vizita të realizuara 2017-2019 ........ 23
Grafiku 10: Deklarimet elektronike sipas muajve ........ 32
Grafiku 11: Deklarimet elektronike sipas llojeve të tatimeve ........ 32
Grafiku 12: Paraqitja grafike e rimbursimeve për kuponë fiskal ........ 36
Grafiku 13: Paraqitja grafike e  inkasimit të borxheve 2017-2019 ........ 38

## FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM



Kam kënaqësinë si Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, t'ju ofroj Raportin Vjetor të punës për vitin 2019, në formatin e plotë përbrenda kornizës së përcaktuar me Ligjin Nr.03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet e ATK-së, së bashku me stafin e angazhuar që ka kontribuar në rezultatet pozitive të organizatës, duke i ofruar buxhetit të Republikës së Kosovës plotësimin e nevojave të planifikuara.

Krahas qëllimit kryesor në vjeljen e të hyrave, ATK zhvillon aktivitete të shumta të bazuara në Planin Strategjik 2015-2020, si dhe planet tjera vjetore e periodike duke ofruar shërbime më të mira për tatimpaguesit, ngritje të profesionalizimit e transparencës, perceptim më të mirë mbi integritetin dhe ndershmërinë drejt ngritjes vullnetare në pagesën e tatimeve.

Të gjitha këto, ATK i ka bazuar në rritjen e aftësive të stafit, përmirësimin e proceseve kyçe tatimore, si për tatimpaguesit ashtu edhe për stafin e ATK-së, sigurimin e një strukture organizative efektive, ripërtëritjen e teknologjisë informative për punë më efektive dhe efikase, si dhe zvogëlimin sa më të madh të nivelit të ekonomisë jo-formale.

Sigurisht që të arriturat e ATK-së krahas stafit të brendshëm, janë të ndërlidhura edhe me aktivitete të realizuara me institucionet tjera vendore por edhe ndërkombëtare, të cilat janë duke ofruar ekspertizë dhe profesionalizëm, për të mbajtur ATK-në në hap me organizatat moderne simotra. Me këtë dëshiroj të shpreh mirënjohjen për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve, si në raport me tatimpaguesit ashtu edhe me stafin e brendshëm.

Gjithashtu, duhet të çmoj lartë përkushtimin dhe angazhimet profesionale të stafit të organizatës sonë, në arritjen e objektivave dhe përmirësimin e imazhit të ATK-së, duke i ofruar shoqërisë sonë një mirëqenie më të mirë për të ardhmen.

Administrata Tatimore e Kosovës

Ilir Murtezaj, Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së

Prishtinë, Mars 2020

# HYRJE

Përgatitja e raporteve nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës është një përditshmëri të cilat mbulojnë aktivitetet e shumta të stafit të ATK-së nga puna në teren, por edhe aktivitete të shumta të punës në ndihmë për njerëzit në terren. Po ashtu janë edhe raporte tjera që lidhen me punën e ATK-së me institucionet vendore, por edhe institucionet e shumta ndërkombëtare.

Raporti Vjetor i ATK-së për vitin 2019 është edhe një kërkesë ligjore e dalë nga Paragrafi 2 dhe 3 i Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat ku janë të përvijuara pikat për raportim.

Me këtë raport kemi paraqitur detajet mbi buxhetin e ATK-së, stafin, të hyrat e mbledhura së bashku me koston, detyrimet e anuluara, ndjekjet penale në fushën e tatimeve si dhe ankesat e tatimpaguesve. Të gjitha këto janë të shoqëruara me detaje dhe të dhëna të shumta që pasqyrojnë punën në shumë drejtime të specializuara si në fushën e tatimeve ashtu edhe në fusha tjera të përbashkëta dhe të veçanta të stafit të ATK-së, por edhe të ndihmuar nga institucione ndërkombëtare në specializimin dhe ngritjen e kapaciteteve të organizatës.

Sigurisht që kjo punë është shoqëruar edhe me sukses në mbledhjen e të hyrave, ngritjen e imazhit të ATK-së si brenda vendit ashtu edhe jashtë.

ATK mbetet e përkushtuar të plotësoj dhe tejkaloj detyrimet kundrejt ligjeve, Qeverisë, institucioneve vendore, por edhe atyre ndërkombëtare dhe të jetë shtysë në zhvillimin e vendit dhe shoqërisë.



# I. HISTORIKU

ATK, është themeluar me datë 17 Janar 2000, nën drejtimin dhe administrimin e UNMIK-ut. Nga muaji shkurt i vitit 2003, barten kompetencat e udhëheqjes nga UNMIK-u tek Ministria për Ekonomi dhe Financa, dhe që nga ajo kohë, ATK funksionon si agjenci ekzekutive me autonomi të plotë operuese e menaxhuar krejtësisht nga vendorët me asistencën e organizatave donatore ndërkombëtare përfshirë USAID-in, BE-në, FMN-në, etj.

Fillimisht ATK-ja ka administruar Tatimin në Hoteleri dhe Restorante, i cili është zëvendësuar me Tatimin e Paragjykuar, ku janë tatuar të gjitha të ardhurat biznesore. TVSh, ka filluar të aplikohet që nga data 01.07.2001.

Në prill të vitit 2002, ka filluar të aplikohet Tatimi në Paga, si dhe Tatimi në Fitim për personat juridik, të cilët deri në atë kohë janë tatuar me Tatim të Paragjykuar. Nga Janari i vitit 2005 është bërë një reformë tatimore, duke zëvendësuar Tatimin e Paragjykuar, Tatimin në Paga dhe Tatimin në Fitim me dy lloje të reja të tatimeve si: Tatimi në të Ardhura Personale, i cili taton personat fizik dhe Tatimi në të Ardhura të Korporatave, i cili taton personat juridik. Sistemi tatimor në Kosovë, ka evoluar nga sistemi i Rregulloreve të UNMIK-ut, në sistemin e ligjeve tatimore të nxjerra nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Këto ligje, konsiderohen të jenë të kuptueshme dhe të lehta për administrim dhe zbatim.

# 1. BUXHETI

Buxheti për të gjitha kategoritë ekonomike në vitin 2019 është planifikuar në vlerë prej 11.8 milion EUR, nga këto mjete për periudhën janar-dhjetor janë shpenzuar 11.1 milion EUR, prej të cilave për paga dhe mëditje janë shpenzuar 7,5 milion EUR ose 67.3% e shpenzimeve totale, për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 2,3 milion EUR ose 21.0%, për shpenzime komunale janë shpenzuar 150.9 mijë EUR ose 1.4% dhe për shpenzime kapitale janë shpenzuar 1,1 milion EUR ose 10.3%. Në krahasim me vitin e kaluar shpenzimet janë më të mëdha për 19.4%, në këtë ka ndikuar shpenzimet në kategorinë e projekteve Kapitale.

Tabela e shpenzimeve të buxhetit sipas kategorive ekonomike:

| Regjioni | 2017 | 2018 | 2019 | Buxheti 2019 | Struktura | Krahasimi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6=4/∑ | 7=4/5 | 8=4/3 |
| Pagat dhe mëditjet | 6,881,449 | 7,231,019 | 7,455,035 | 7,455,035 | 67.3% | 100.0% | 103.1% |
| Mallrat dhe shërbimet | 1,528,474 | 1,750,985 | 2,320,511 | 2,390,597 | 21.0% | 97.1% | 132.5% |
| Shpenzimet komunale | 166,071 | 172,130 | 150,906 | 271,696 | 1.4% | 55.5% | 87.7% |
| Shpenzimet kapitale | 231,453 | 117,709 | 1,143,026 | 1,700,709 | 10.3% | 67.2% | 971.1% |
| Gjithsej | 8,807,447 | 9,271,843 | 11,069,478 | 11,818,037 | 100.0% | 93.7% | 119.4% |

Tabela 1: Shpenzimet e buxhetit 2019, krahasimi me vitin 2018 dhe 2017
Burimi: Divizioni i Buxhetit




Grafiku 1: Buxheti i shpenzuar
Burimi: Divizioni i Buxhetit

## 2. BURIMET NJERËZORE

Gjatë kësaj periudhe raportuese Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë 110 vendime për transfer të brendshëm, në pajtim me rregullat dhe procedurat e menaxhimit të personelit.
Gjate kësaj periudhe raportuese janë shqyrtuar 12 raste nga Komisionin Disiplinor ku komisioni për dhjetë (10) raste ka marre vendim negativ ,dy (2) raste janë pezulluar. Komisioni për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave ka shqyrtuar 85 raste, 49 rastet janë refuzuar si te pabazuara, 30 raste pozitiv për ankuesin dhe 6 raste në rishqyrtim.
Vërejtje te shqiptuara për këtë periudhe raportuese kemi shtatëdhjetë e gjashtë(76) vërejtje, prej tyre shtatëdhjetë (70) janë vërejtje me gojë dhe gjashtë ( 6) vërejtje me shkrim.
Tre (3) punëtorëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.
Vdekje e zyrtarit një (1).
Ndërprerje e marrëdhënies se punës me Vendim te Gjykatës një (1).
Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me vetë dëshire dy (2).

Gjatë periudhës janar-shtator/2019 ATK-së Divizioni i BNJ ka bërë shpalljen e 60 konkurseve të brendshme dhe 4 konkurseve të jashtme prej tyre 20 inspektor te rinj kane filluar punën me date 13.05.2019.
ATK-së ka pranuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës 4 vendime ku 2 prej tyre janë negativ për ATK-se, 2 vendime janë zbatuar nga ATK-se, 55 përgjigje në ankesë për KPMK.
Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe raportuese janë përcjell shkresa ne zyrat regjionale dhe Drejtorin e Përgjithshme mbi mungesat dhe vijueshmërinë në punë për tërë stafin.

Divizioni i Burimeve Njerëzore ka zhvilluar edhe këto aktivitete: Ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve të ndryshme në kërkesat e menaxherëve dhe stafit tjetër të ATK-së rreth procesit të vlerësimit të kryerjes së detyrave të punës. Lëshimin e vërtetimeve si dëshmi mbi ekzistimin e marrëdhënien së punës së të punësuarve në ATK. Njoftime me rregulla te brendshme te miratuara nga kompetentet e qe ndërlidhen me menaxhimin e te punësuarve ne ATK. Ofrimin e këshillave të ndryshme profesionale që ndërlidhen me Shërbimin Civil në Kosovë; Përcjelljen e shkresave të ndryshme si përmes fax-it ashtu edhe përmes formave të tjera, postës, emalit, etj. Mbajtjen e rregullt të evidencës mbi numrin e të punësuarve të ATK-së të cilët gjenden në pushime (pushim vjetor, pushim lehonie, pushim pa pagesë, te suspenduar, etj.).

Me datë 10.05.2019 Drejtori i Përgjithshëm i ATK-se ka krijuar Strukturën e re Organizative me qellim te funksionalizimit me te mire te ATK-se dhe arritjes se objektivave .

Numri i të punësuarve në Administratën Tatimore është 830[1], prej tyre 557 meshkuj dhe 273 femra. Në vitin 2019 janë pensionuar 3 zyrtarë[2].

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar nga Ministria e Financave me Universitetin e Prishtinës 2019 (MF-UP-ATK), në Administratën Tatimore kanë vijuar praktikën 60 studentë[3], gjithashtu praktikën në ATK e kanë ndjekur 20 persona[4] të tjerë.

Numri i të punësuarve sipas strukturës kualifikuese, etnike dhe gjinore:

| Numri i përgjithshëm i të punësuarve | Struktura kualifikuese | | | | Struktura etnike | | | | Struktura gjinore | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Superior | Lartë | Mesëm | Fillor | Shqiptar | Serb | Turq | Tjerë | Meshkuj | Femra | Gjithsej të punësuar |
| Gjithsej | 758 | 9 | 62 | 1 | 790 | 32 | 2 | 6 | 557 | 273 | 830 |
| % | 91.3% | 1.1% | 7.5% | 0.1% | 95.2% | 3.9% | 0.2% | 0.7% | 67.1% | 32.9% | 100.0% |

Tabela 2: Gjendja e numrit të punësuarve përfshi strukturën kualifikuese, etnike dhe gjinore
Burimi: Divizioni i Burimeve Njerëzore




Grafiku 2: Numri dhe struktura gjinore e të punësuarve

[1] Lista e të punësuarve në Administratën Tatimore të Kosovës (shtojca nr.1)
[2] Lista e punëtorëve të pensionuar (shtojca nr.2)
[3] Lista e studenteve praktikantë sipas marrëveshjes me Ministrinë e Financave dhe Universitetin e Prishtinës 2019 (MF-UP-ATK) (shtojca nr.3)
[4] Lista e studentëve që kanë ndjekur praktikën në ATK (shtojca nr.4)

Shpërndarja gjeografike e numrit të përgjithshëm të punësuarve në ATK, datë 31.12.2019:

| Regjioni | Numri i stafit | % | Gjinia | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Meshkuj | % | Femra | % |
| DTM | 51 | 6.1% | 39 | 7.0% | 12 | 4.4% |
| Prishtinë 1 | 63 | 7.6% | 47 | 8.4% | 16 | 5.9% |
| Prishtinë 2 | 57 | 6.9% | 38 | 6.8% | 19 | 7.0% |
| Prishtinë 3 | 56 | 6.7% | 40 | 7.2% | 16 | 5.9% |
| Gjilan | 67 | 8.1% | 48 | 8.6% | 19 | 7.0% |
| Ferizaj | 66 | 8.0% | 49 | 8.8% | 17 | 6.2% |
| Prizreni 1 | 45 | 5.4% | 32 | 5.7% | 13 | 4.8% |
| Prizreni 2 | 32 | 3.9% | 25 | 4.5% | 7 | 2.6% |
| Gjakovë | 26 | 3.1% | 19 | 3.4% | 7 | 2.6% |
| Pejë | 54 | 6.5% | 38 | 6.8% | 16 | 5.9% |
| Mitrovicë | 70 | 8.4% | 53 | 9.5% | 17 | 6.2% |
| Hetimet Tatimore | 20 | 2.4% | 18 | 3.2% | 2 | 0.7% |
| Arkat Fiskale | 11 | 1.3% | 6 | 1.1% | 5 | 1.8% |
| ZGJONA | 9 | 1.1% | 5 | 0.9% | 4 | 1.5% |
| Qendra e Thirrjeve | 11 | 1.3% | 2 | 0.4% | 9 | 3.3% |
| Drejtoria | 176 | 21.2% | 96 | 17.2% | 80 | 29.3% |
| QESHT | 16 | 1.9% | 2 | 0.4% | 14 | 5.1% |
| Gjithsej | 830 | 100.0% | 557 | 100.0% | 273 | 100.0% |

Tabela 3: Numri i të punësuarve në ATK, viti 2019
Burimi: Divizioni i Burimeve Njerëzore

## 2.1. TRAJNIMET

Gjatë kësaj periudhe ky divizion ka realizuar dhe ofruar mbështetje teknike për trajnimin e stafit, nga ATK-ja, si dhe organizatat vendore e ndërkombëtare janë organizuar 96 trajnime, nga fushat e ndryshme të legjislacionit tatimor, ku kanë marrë pjesë 705 zyrtarë. Janë mbajtur 10 vizita studimore/punëtori, ku kanë marrë pjesë 79 zyrtarë.

Numri i trajnimeve dhe pjesëmarrësve sipas institucioneve vendore dhe ndërkombëtare:

| Organizatori | Numri i trajnimeve të mbajtura | Numri i pjesëmarrësve | Numri i ditëve |
|---|---|---|---|
| CEPOL | 9 | 10 | 44 |
| Giz | 19 | 218 | 31 |
| IKAP | 7 | 12 | 16 |
| ShKÇAK | 2 | 71 | 10 |
| Telekomi i Kosovës (TK) | 15 | 30 | 50.5 |
| CEF | 7 | 17 | 21 |
| Ambasada e Britanisë së Madhe | 3 | 3 | 22 |
| ATK | 17 | 298 | 35.5 |
| OECD | 3 | 7 | 15 |
| Prudencia Consulting | 3 | 13 | 13 |
| InfoSec SEE | 1 | 3 | 2 |
| EDC | 2 | 5 | 8 |
| Ambasada e Amerikës në Kosovë | 1 | 1 | 3 |
| OSBE | 1 | 2 | 1 |
| FLSA | 2 | 3 | 8 |
| IKM | 2 | 4 | 10 |
| KMT | 1 | 4 | 5 |
| Nettrik | 1 | 4 | 5 |
| Totali | 96 | 705 | 300 |

Tabela 4: Numri i trajnimeve dhe pjesëmarrësve sipas institucioneve vendore dhe ndërkombëtare
Burimi: Raporti i Divizionit te Trajnimeve

Punëtoritë/konferencat/vizitat e punës për zyrtarët e ATK-së

| Organizatori | Kurset | Numri i pjesëmarrësve | Nr.i ditëve |
|---|---|---|---|
| MF | Konferenve "The digjital future of national finance" | 1 | 2 |
| ATK | Punëtori për UE të kontrollit | 64 | 1 |
| CEF | Tryezë e rrumbullakët në Bosnje dhe Hercegovinë | 3 | 2 |
| Instituti i Auditim të Brendshëm i Kroacisë | Konferencë për Auditim të Brendshëm në Kroaci | 1 | 3 |
| Uniglobal Events | Samiti për proceset e digjitalizimit të TVSH-së | 2 | 2 |
| Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | Vizitën zyrtare në Latvia | 1 | 5 |
| UNODC | Vizitë zyrtare në Austiri | 1 | 3 |
| OSCE | Masat e standardizuara për zbulimin e vjedhjeve të rënda | 1 | 1 |
| ShKÇAK | Seminari "SNRF 16 – Lizingu – SNRF 17 – Kontratat e Sigurimeve" | 1 | 2 |
| Instituti për Auditim të Brendshëm i Malit të Zi | Konferencë për Auditim të Brendshëm | 4 | 1 |
| Gjithsej | | 79 | 22 |

Tabela 5: Numri i konferencave/punëtori
Burimi: Divizioni i Trajnimeve

# 3. TË HYRAT

## 3.1. TË HYRAT DHE STRUKTURA E TYRE

Administrata Tatimore e Kosovës, gjatë periudhës raportuese ka realizuar të hyra në vlerë prej 504.3 milion EUR , që në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë realizuar të hyra për 10.4% më shumë ose shprehur në vlerë për 47.4 milion EUR , ndërsa krahasuar me planin në lartësi prej 516.4 milion EUR , për këtë periudhë janë realizuar 97.7% e planit.
Kontributet Pensionale për këtë periudhë janë mbledhur në vlerë prej 188.3 milion EUR mil. Gjithsej, Tatime dhe Kontribute Pensionale 504.3 + 188.3 = 692.6 milion EUR , që në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë mbledhur për 62.1 milion EUR më shumë.

Gjatë kësaj periudhe, ATK ka zhvilluar aktivitete të rëndësishme të cilat kanë rol të veçantë në realizimin e misionit dhe vizionit të saj si një administratë moderne. Janë bërë ndryshime në Sistemin e Ri Elektronik Tatimor - EDI, i cili është më i avancuar, është më i përshtatshëm për aplikim, në të cilin janë përfshirë veçori të reja, të cilat do të lehtësojnë deklarimin dhe pagesën e tatimeve.
Zhvillimi i aplikacioneve te reja si :Avancimi I Aplikacionit te Rimbursimit me modulin e administrimit, Avancimi I Analiza se Rrezikut, Implementimi WEB API për Tatimin në pronë, Krijimi I veglës për bartjen e ndryshimeve nga ARBK në ATK, Krijimi I WEB API-t për bllokim në Dogana, Krijimi I WEB API-t për Certifikata në Dogana, Automatizimi I kategorizimit në modulin e Rimbursimit, Implementimi WEB API për ICK, Implementimi WEB API për marrjen e statusit të barrës QAK, përmes GG, Implementimi WEB API për marrje e të dhënave për biznesin QAK, përmes GG, Dizajnimi I dokumentit teknik për zhvillim të SMRM, Implementimi WEB API për MPMS.
Menaxhmenti i ATK-së është angazhuar me një përkushtim të veçantë të sigurimit të përkrahjes së ATK-së në projektin e zëvendësimit të Sistemit të TI-së si faktorë kyç në modernizimin e Administratës Tatimore, projekt ky si objektivë strategjike e ATK-së për periudhën kohore 2015-2020.

ATK është duke u bazuar në Planin Strategjik për periudhën 2015-2020, ku nëpërmjet kësaj strategjie parashihet profesionalizimi, integriteti, efikasiteti dhe përsosmëria e shërbimeve.

Përkundër vështirësive që sfidojnë, ATK është e vendosur të vazhdojë me përkushtimin të realizojë suksese të mëtutjeshme në misionin e saj, mbledhjen e të hyrave duke respektuar kornizat ligjore. ATK, në vazhdimësi do të bëjë përpjekje në ngritjen e përmbushjes vullnetare, duke ofruar shërbime profesionale, transparente dhe efektive, në zbatim të drejtë dhe të njëllojshëm të ligjeve tatimore.

Në vijim paraqesim tabelën për tatimpaguesit që kanë deklaruar qarkullimin dhe paguar, për periudhën 2017-2019

| VITET | 2017 | 2018 | 2019 |
|---|---|---|---|
| Nr. i tatimpaguesve deklarues | 65,259 | 67,702 | 73,164 |
| Nr. i bizneseve deklaruese | 61,046 | 64,303 | 69,433 |
| Nr. i bizneseve që deklarojnë qarkullim > 0 | 39,506 | 40,147 | 41,582 |
| Nr. i tatimpaguesve që kanë paguar (sipas periudhës) | 45,320 | 47,159 | 49,811 |
| Nr. i tatimpaguesve që kanë paguar (sipas datës së pagesës) | 50,057 | 49,329 | 52,033 |
| Vlera e qarkullimit te deklaruar | 10,153,775,256 | 11,104,787,638 | 11,870,714,167 |

Tabela 6: Tatimpaguesit që deklarojnë qarkullim dhe pagesa, 2017-2019
Burimi: ATK-DB




Grafiku 3: Paraqitja grafike e të hyrave të realizuara dhe kontributeve pensionale sipas viteve 2017-2019

## 3.2. TË HYRAT SIPAS MUAJVE

Trendi i të hyrave sipas muajve, në muajin Janar 2019 në krahasim me 2018 të hyrat kanë shënuar rritje për 14.6%, në muajin Shkurt janë me të larta për 7.3% , në Mars janë më të larta për 6.8%, Prill 7.1%, Maj 11.1%, në Qershor janë për 0.2% më pak, në Korrik janë më të larta për 22.1%, Gusht për 17.0% , Shtator për 2.2%, Tetor 9.3%, Nëntor 10.0% dhe në Dhjetor 10.6% më të larta.
Krahasuar me planin vjetor 2019 prej 516.4 milion EUR , për këtë periudhë janë realizuar të hyrat më pakë për 2.3%.

Në vijim paraqesim të hyrat e realizuara sipas muajve, në krahasim me planin dhe vitet paraprake:

| Muaji | Realizimi sipas viteve | | | % e pjesëmarrjes | Plani 2019 | Krahasimi realizim-plan 2019 | Krahasimi realizim 2019/2018 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2017 | 2018 | 2019 | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5=4/∑ | 6 | 7=4/6 | 8=4/3 |
| Janar | 45,339,032 | 51,402,067 | 58,887,548 | 11.7% | 58,225,409 | 101.1% | 114.6% |
| Shkurt | 22,905,501 | 27,534,521 | 29,536,675 | 5.9% | 31,054,352 | 95.1% | 107.3% |
| Mars | 26,734,857 | 28,805,608 | 30,772,598 | 6.1% | 32,511,813 | 94.7% | 106.8% |
| Prill | 47,555,209 | 56,702,928 | 60,748,192 | 12.0% | 64,251,345 | 94.5% | 107.1% |
| Maj | 24,870,268 | 29,161,851 | 32,402,378 | 6.4% | 32,908,914 | 98.5% | 111.1% |
| Qershor | 25,454,902 | 26,327,772 | 26,281,527 | 5.2% | 29,639,753 | 88.7% | 99.8% |
| Korrik | 45,753,664 | 47,891,313 | 58,458,632 | 11.6% | 54,218,911 | 107.8% | 122.1% |
| Gusht | 30,574,381 | 32,766,210 | 38,344,982 | 7.6% | 37,007,420 | 103.6% | 117.0% |
| Shtator | 34,594,211 | 36,135,375 | 36,914,062 | 7.3% | 40,846,709 | 90.4% | 102.2% |
| Tetor | 47,047,250 | 54,944,526 | 60,079,481 | 11.9% | 62,241,490 | 96.5% | 109.3% |
| Nëntor | 31,066,453 | 30,235,213 | 33,267,597 | 6.6% | 34,100,278 | 97.6% | 110.0% |
| Dhjetor | 32,459,566 | 34,891,111 | 38,588,195 | 7.7% | 39,393,606 | 98.0% | 110.6% |
| Gjithsej | 414,355,294 | 456,798,495 | 504,281,866 | 100.0% | 516,400,000 | 97.7% | 110.4% |
| K. Pens. | 159,313,875 | 173,657,367 | 188,348,268 | | | | |

Tabela 7: Të hyrat e realizuara sipas muajve 2017-2019
Burimi: MF-Thesar / ATK

## 3.3. TË HYRAT SIPAS LLOJEVE TË TATIMEVE

Në strukturën e të hyrave sipas llojeve të tatimeve, pjesëmarrje më të madhe ka TVSh-ja me 47.9%, pastaj Tatimi në Korporata me 18.9%, Tmb-pagat tjera me 14.0%, Tmb-pagat buxhetore me 7.5%, Tatimi për Bizneset Individuale me 6.5% dhe Tatimi në interes, dividendë, të drejta pronësore, qira, fitore në lotari dhe lojëra të fatit 5.1%.

Tabela e të hyrave sipas llojeve të tatimeve për vitin 2019

| Llogaritë tatimore | Të hyrat për periudhën Janar-Dhjetor/2017-2019 | | | % | Plani 2019 | Krahasimi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2017 | 2018 | 2019 | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5=4/∑ | 6 | 7=4/6 | 8=4/3 |
| Tatimi mbi vlerën e shtuar | 196,635,189 | 215,184,335 | 241,711,051 | 47.9% | 244,840,755 | 98.7% | 112.3% |
| Tatimi në pagat buxhetore | 29,169,945 | 32,609,602 | 37,823,265 | 7.5% | 35,657,934 | 106.1% | 116.0% |
| Tatimi në pagat tjera | 57,391,152 | 65,411,366 | 70,595,169 | 14.0% | 72,518,297 | 97.3% | 107.9% |
| Tatimi për biznese individ. | 35,148,476 | 34,067,683 | 32,948,635 | 6.5% | 38,762,845 | 85.0% | 96.7% |
| Interes, qira, drejta prons. etj | 18,073,875 | 22,177,062 | 25,911,208 | 5.1% | 25,233,476 | 102.7% | 116.8% |
| Tatimi në korporata | 77,936,657 | 87,348,447 | 95,292,538 | 18.9% | 99,386,694 | 95.9% | 109.1% |
| Gjithsej | 414,355,294 | 456,798,495 | 504,281,866 | 100.0% | 516,400,000 | 97.7% | 110.4% |

Tabela 8: Të hyrat e realizuar sipas llojit të tatimeve, krahasuar me vitet paraprake
Burimi: Raporti i punës Janar-Dhjetor 2019, ATK




Grafiku 4: Paraqitja grafike sipas llojeve të tatimeve

<u>LEGJENDA:</u>
TVSH - Tatimi mbi vlerën e shtuar
TB - Tatimi i mbajtur në burim-paga buxhetore
TB - Tatimi i mbajtur në burim-Pagat tjera
PD - Tatimi për Bizneset individuale
WR - Tatimi në interes, dividendë, të drejta pronësore, qira, fitore në lotari dhe lojëra të fatit
CD - Tatimi për Korporata

## 3.4. TË HYRAT SIPAS LLOJEVE KRYESORE TË TATIMEVE

Në të hyrat sipas llojeve kryesore të tatimeve, pjesëmarrje më të madhe ka Tatimi në Vlerën e Shtuar (TVSh) me 47.9%, pastaj Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP) me 28.0% dhe Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK) me 24.0%.

Të hyrat sipas tri llojeve kryesore të tatimeve për vitin 2017-2019:

| Lloji i tatimit | 2017 | 2018 | 2019 | Struktura 2019 | Krahasimi sipas viteve | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5=4/∑ | 6=4/2 | 7=4/3 |
| TVSH | 196,635,189 | 215,184,335 | 241,711,051 | 47.9% | 122.9% | 112.3% |
| TAK | 96,010,532 | 109,525,509 | 121,203,746 | 24.0% | 126.2% | 110.7% |
| TAP | 121,709,573 | 132,088,652 | 141,367,069 | 28.0% | 116.2% | 107.0% |
| Total | 414,355,294 | 456,798,495 | 504,281,866 | 100.0% | 121.7% | 110.4% |

Tabela 9: Të hyrat e realizuara sipas viteve dhe llojeve kryesore të tatimeve
Burimi: Raporti i punës Janar-Dhjetor 2019, ATK




Grafiku 5: Paraqitja grafike e të hyrave sipas viteve dhe llojeve kryesore të tatimeve

## 3.5. TË HYRAT NË DTM DHE DREJTORI RAJONALE 2017-2019

Në shumën e përgjithshme të hyrave të realizuara për këtë periudhë në vlerë prej mbi 504.3 milion EUR, Departamenti i Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) merr pjesë me 47.0%, apo shprehur në vlerë mbi 237.0 milion EUR, pastaj regjioni Prishtina 1 me 10.9%, apo shprehur në vlerë mbi 54.7 milion EUR ,ndërkohë që regjionet tjera marrin pjesë me më pak se 10% të hyrave të përgjithshme në këtë periudhë, si vijon:

Tabela e të hyrave në DTM dhe Drejtori rajonale 2017-2019:

| Regjioni | Të hyrat sipas viteve | | | % | Plani 2019 | Krahasimi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2017 | 2018 | 2019 | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5=4/∑ | 6 | 7=4/6 | 8=4/3 |
| DTM | 204,125,517 | 211,690,757 | 237,018,678 | 47.0% | 252,007,169 | 94.1% | 112.0% |
| Prishtinë 1 | 41,093,121 | 50,164,404 | 54,793,352 | 10.9% | 55,735,183 | 98.3% | 109.2% |
| Prishtinë 2 | 28,369,264 | 32,445,845 | 33,442,766 | 6.6% | 34,623,660 | 96.6% | 103.1% |
| Prishtinë 3 | 33,624,151 | 38,943,703 | 41,267,018 | 8.2% | 43,481,451 | 94.9% | 106.0% |
| Gjilan | 12,218,093 | 13,971,836 | 14,860,714 | 2.9% | 13,058,371 | 113.8% | 106.4% |
| Ferizaj | 14,676,999 | 15,884,717 | 17,647,317 | 3.5% | 17,966,483 | 98.2% | 111.1% |
| Prizren 1 | 11,820,276 | 14,348,337 | 16,873,219 | 3.3% | 16,354,687 | 103.2% | 117.6% |
| Prizren 2 | 9,954,464 | 11,910,552 | 13,597,595 | 2.7% | 12,622,742 | 107.7% | 114.2% |
| Gjakovë | 6,563,899 | 7,857,175 | 8,860,573 | 1.8% | 7,563,849 | 117.1% | 112.8% |
| Pejë | 12,684,282 | 14,044,638 | 15,072,821 | 3.0% | 14,772,882 | 102.0% | 107.3% |
| Mitrovicë | 10,055,283 | 12,926,929 | 13,024,547 | 2.6% | 12,555,589 | 103.7% | 100.8% |
| Z. Qendrore | 29,169,945 | 32,609,602 | 37,823,265 | 7.5% | 35,657,934 | 106.1% | 116.0% |
| Gjithsej | 414,355,294 | 456,798,495 | 504,281,866 | 100.0% | 516,400,000 | 97.7% | 110.4% |

Tabela 10: Të hyrat e realizuara krahasuar me planin për DTM dhe drejtori rajonale 2017 -2019
Burimi: Teknologjia Informative (SharePoint)

Te të hyrat në Prishtinën 1 për vitin 2017 dhe 2018 janë zbrit te hyrat nga pagat buxhetore dhe janë paraqit te Zyra Qendrore.[5]




Grafiku 6: Paraqitja grafike e të hyrave sipas drejtorive rajonale

[5] Në Zyren.Qendrore: TMB-Pagat Buxhetore

## 3.6. TË HYRAT E GRUPUARA NË DTM DHE DREJTORI RAJONALE

Nga të hyrat e realizuara sipas DTM-së dhe dy grupeve te tjera të rajoneve kemi këtë gjendje:
Në DTM në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar përqindja e realizimit është rritur prej 12.0% në Drejtoritë rajonale Prishtina 1, 2 dhe 3 kemi rritje prej 6.5%, ndërsa në Drejtoritë tjera rajonale kemi rritje prej 11.5%.

Në krahasim me planin e vitit 2019, në DTM përqindja e realizimit është 94.1%, në rajonet Prishtina 1, 2 dhe 3 përqindja e realizimit është 96.8%, ndërsa në rajonet tjera përqindja e realizimit është 105.5%.

Tabela e të hyrave të grupuara në tri rajone:

| Regjioni | Të hyrat sipas viteve | | | % | Plani 2019 | Krahasimi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2017 | 2018 | 2019 | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5=4/∑ | 6 | 7=4/6 | 8=4/3 |
| DTM | 204,125,517 | 211,690,757 | 237,018,678 | 47.0% | 252,007,169 | 94.1% | 112.0% |
| Prishtinë 1 2 3 | 103,086,536 | 121,553,952 | 129,503,137 | 25.7% | 133,840,294 | 96.8% | 106.5% |
| Rajonet tjera | 107,143,241 | 123,553,787 | 137,760,051 | 27.3% | 130,552,537 | 105.5% | 111.5% |
| Gjithsej | 414,355,294 | 456,798,495 | 504,281,866 | 100.0% | 516,400,000 | 97.7% | 110.4% |

Tabela 11: Të hyrat e grupuara në DTM dhe Drejtori rajonale
Burimi: Teknologjia Informative (SharePoint)

# 4. KOSTO E VLERAVE TE TRAJTUARA PËR 100 €/NJËSI

Tabela e kostove për çdo 100 njësi, për vitin 2019:

| Viti | Vlerat e trajtuara (tatimet + kontribute pensionale) | Shpenzimet e ATK-së pa shpenzimet kapitale | Kostoja e vlerave të trajtuar për çdo 100€/njësi |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4=3/2*100 |
| 2017 | 573,590,664 | 8,575,994 | 1.50 |
| 2018 | 619,776,023 | 9,154,134 | 1.48 |
| 2019 | 692,630,134 | 9,926,452 | 1.43 |

Tabela 12: Kosto e vlerave për 100 €/njësi në mbledhjen e të hyrave
Burimi: Raporti vjetor i të hyrave për vitet 2017 - 2019

## 5. TATIMI SHTESË NGA KONTROLLET SIPAS RAJONEVE

Si rezultat i kryerjes së 1,915 kontrolleve tatimore dhe vlerësimeve nga zyra, janë realizuar tatim shtesë në vlerë prej 55.5 milion EUR , e që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, realizimi i tatimit shtesë është më i ulët për 426.3 mijë EUR ose shprehur në përqindje për 0.8 %. Gjithashtu në këtë periudhë kemi edhe një ulje të kreditimit në vlerë prej 14.2 milion EUR, dhe zvogëlim të humbjes në vlerë prej 79.6 milion EUR.

Tabela e tatimit shtesë të kontrolleve të kryera 2017-2019:

| Regjioni | Tatimi shtesë | | | % | Krahasimi | Ulja e kreditimit 2019 | Zvogëlimi i humbjes 2019 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2017 | 2018 | 2019 | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5=4/∑ | 6=4/3 | 7 | 8 |
| DTM | 22,458,713 | 22,564,912 | 22,387,453 | 40.3% | 99.2% | 972,799 | 49,843,651 |
| PRISHTINË 1 | 4,917,278 | 8,699,121 | 4,371,530 | 7.9% | 50.3% | 1,339,752 | 1,777,442 |
| PRISHTINË 2 | 3,111,304 | 3,304,716 | 4,180,873 | 7.5% | 126.5% | 3,836,340 | 6,001,085 |
| PRISHTINË 3 | 5,350,629 | 5,128,239 | 4,035,725 | 7.3% | 78.7% | 1,292,308 | 3,301,439 |
| GJILAN | 4,481,009 | 2,655,902 | 2,655,015 | 4.8% | 100.0% | 978,661 | 1,993,944 |
| FERIZAJ | 4,276,539 | 3,013,581 | 3,618,520 | 6.5% | 120.1% | 923,364 | 3,211,807 |
| PRIZREN 1 | 1,658,789 | 1,327,840 | 3,276,176 | 5.9% | 246.7% | 1,735,020 | 4,863,913 |
| PRIZREN 2 | 1,669,448 | 1,335,441 | 2,161,346 | 3.9% | 161.8% | 1,084,234 | 1,687,752 |
| GJAKOVË | 512,977 | 419,545 | 473,315 | 0.9% | 112.8% | 302,890 | 794,614 |
| PEJË | 1,705,031 | 2,760,355 | 3,246,861 | 5.8% | 117.6% | 1,096,889 | 4,195,084 |
| MITROVICË | 2,950,847 | 4,813,881 | 5,190,371 | 9.3% | 107.8% | 669,127 | 1,935,821 |
| Gjithsej | 53,092,564 | 56,023,533 | 55,597,186 | 100.0% | 99.2% | 14,231,385 | 79,606,553 |

Tabela 13: Tatimi shtesë 2019 nga kontrollet, krahasuar me vitet 2018 dhe 2017
Burimi: Teknologjia Informative – Moduli VKME




Grafiku 7: Vlera e tatimit shtesë 2017-2019

## 5.1. NUMRI I KONTROLLEVE TË KRYERA NGA INSPEKTORËT TATIMOR

Gjatë kësaj periudhe janë kryer 1,915 kontrolle, ku si rezultat i këtij procesi kemi pasur tatim shtesë në vlerë prej 55.5 milion EUR. Në krahasim me vitin e kaluar numri i kontrolleve të kryera arrin në lartësi prej 111.7 % , ndërsa në krahasim me planin numri i kontrolleve të kryera është 85.3 %.

Tabela e numrit të kontrolleve të kryera 2017-2019:

| Regjioni | Numri I kontrolleve | | | Inspektorët e kontrollit | Plani i kontrolleve 2019 | Krahasimi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2017 | 2018 | 2019 | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7=4/6 | 8=4/3 |
| DTM | 105 | 129 | 121 | 30 | 168 | 72.0% | 93.8% |
| PRISHTINË 1 | 165 | 180 | 211 | 33 | 310 | 68.1% | 117.2% |
| PRISHTINË 2 | 144 | 157 | 164 | 22 | 228 | 71.9% | 104.5% |
| PRISHTINË 3 | 169 | 145 | 168 | 23 | 216 | 77.8% | 115.9% |
| GJILAN | 174 | 229 | 313 | 27 | 314 | 99.7% | 136.7% |
| FERIZAJ | 129 | 175 | 213 | 25 | 232 | 91.8% | 121.7% |
| PRIZREN 1 | 134 | 146 | 161 | 15 | 160 | 100.6% | 110.3% |
| PRIZREN 2 | 126 | 145 | 156 | 14 | 160 | 97.5% | 107.6% |
| GJAKOVË | 66 | 54 | 55 | 4 | 58 | 94.8% | 101.9% |
| PEJË | 138 | 169 | 188 | 17 | 194 | 96.9% | 111.2% |
| MITROVICË | 93 | 185 | 165 | 18 | 206 | 80.1% | 89.2% |
| Gjithsej | 1,443 | 1,714 | 1,915 | 228 | 2,246 | 85.3% | 111.7% |

Tabela 14: Numri i të kontrolleve te kryera 2017-2019, dhe krahasimi me periudhën e njëjtë
Burimi: Teknologjia Informative - Moduli VKME




Grafiku 8: Numri i kontrolleve të kryera sipas viteve, 2017-2019

## 6. VIZITAT PËRMBUSHËSE

Për këtë periudhë janë realizuar gjithsej 38,528 vizita, janë lëshuar 6,490 gjoba mandatare si dhe 383 gjoba për mallin pa origjinë si rezultat i parregullsive të konstatuara. Plani i paraparë i vizitave për këtë periudhë është 29,717 vizita, e që kemi realizim të planit prej 129.6%.

Tabela e vizitave përmbushëse sipas rajoneve:

| Regjioni | Nr i vizitave të realizuara | | | Plani i vizitave 2019 | Krahasimi | | Gjobat mandatore | Gjobat për mallin pa orgjinë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2017 | 2018 | 2019 | | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6=4/5 | 7=4/3 | 8 | 9 |
| PRIZREN 2 | 2,780,660 | 3,731,653 | 3,719,217 | 3.4% | 10,526,242 | 35.3% | 99.7% |
| GJAKOVË | 1,732,633 | 1,847,140 | 2,161,632 | 2.0% | 4,337,373 | 49.8% | 117.0% |
| PEJË | 3,279,546 | 3,855,155 | 5,720,901 | 5.2% | 8,464,194 | 67.6% | 148.4% |
| MITROVICË | 2,610,951 | 3,886,939 | 4,894,389 | 4.5% | 9,290,637 | 52.7% | 125.9% |
| Gjithsej | 62,659,673 | 75,332,172 | 109,112,018 | 100.0% | 142,762,258 | 76.4% | 144.8% |

Tabela 29: Krahasimi i planit dhe inkasimit të borxheve 2017-2019
Burimi: Raportet e Përgjithshme –Analiza e borxheve dhe DKP




Grafiku 13: Paraqitja grafike e inkasimit të borxheve 2017-2019

[7] Inkasimi I borxhit për vitin 2017, 2018 dhe 2019 është marre nga Raportet e Përgjithshme Analiza e Borxheve kurse vlera e Rimbursimit të TVSH-së nga DKP

## 12. HETIMET TATIMORE DHE INTELIGJENCA

DHTI ka realizuar këto aktivitete: 176 aktivitete me qëllim të verifikimit të deklarimeve të sakta apo jo për shmangie tatimore, 117 intervistime, 240 konsultime me Prokurorë, 37 raste të hapura, 48 Kallëzime Penale (raporte të dyshimit fillestar), 1 bastisje, 24 raporte finale hetuese, 193 kërkesa të informatave nga palët e treta dhe 207 informata për palët e treta.

Gjatë kësaj periudhe rezultatet nga shmangia tatimore, janë realizuar në vlerë prej: 5,315,187.67 EUR , pa ndëshkime dhe interesa

Aktivitetet dhe rezultatet e realizuara të DHTI-së

| Aktivitet operative | Intervis time | Bashkëpunimi -Konsultime (takime) me Prokurorë | Raste të hapura | Kallëzime Penale (Rap. i Dyshimit fillestar) | Basti sje | Raporte finale hetuese | Inform ata nga palë të treta | Inform ata për palë të treta | Shmangia tatimore (pa ndëshkime dhe interesa) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 176 | 117 | 240 | 37 | 48 | 1 | 24 | 193 | 207 | 5,315,187 |

Tabela 30: Aktivitetet e realizuara në Njësinë e Hetimeve dhe Inteligjencës
Burimi: Njësia e Hetimeve Tatimore

## 13. AKTIVITETET LIDHUR ME INTERPRETIMET DHE PËRFAQËSIMET LIGJORE

Divizioni për Legjislacion dhe Interpretime Ligjore gjate periudhës janar – dhjetor 2019, në kuadër të fushëveprimit të vet ka zhvilluar dhe realizuar aktivitete si në vijim:
Numri i kërkesave qe i janë drejtuar këtij divizioni nga zyrat regjionale dhe njësitë tjera brenda ATK-se gjatë kësaj periudhe raportuese është 310 sosh, prej te cilave janë përfunduar 308 kurse janë ne proces edhe dy (2) kërkesa dhe ato si ne vijim:
Numri i kërkesave për interpretime ligjore te pranuara ka qene 131, ku janë realizuar 130 dhe vetëm një (1) është ne proces;
- Numri i kërkesave për këshilla dhe opinione ligjore ka qene 55, prej te cilave janë përfunduar te gjitha 55 ;
- Numri i përgjigjeve ne kërkesat për sqarime dhe informata tjera gjate kësaj periudhe ka qene 124 ndaj te cilave për 123 kërkesa janë kthyer përgjigjeje ne proces është edhe 1.
Pjesëmarrja e zyrtareve te këtij divizioni ne takimet e ndryshme te grupeve punues gjate periudhës raportuese është si me poshtë:
-Pjesëmarrja ne takime te grupeve punuese ndërministrore jashtë ATK-se ka qene 44 prej gjithsejtë 44 takimeve te mbajtura, kurse
Pjesëmarrja ne takime te grupeve punuese brenda Administratës Tatimore ka qene 90 takime nga gjithsejtë 90 te organizuara.

- Gjatë periudhës raportuese zyrtaret e këtij divizioni kane marre pjese ne 188 takime zyrtare me zyrtare tatimor te ndryshëm nga zyrat regjionale apo departamente të ndryshme brenda Zyrës Qendrore ne funksion te ofrimit te mbështetës juridike për çështje te caktuara nga aspekti ligjor.
Po ashtu, numri i pjesëmarrjes te zyrtareve te këtij divizioni ne komisione te ndryshme te themeluara nga Drejtori i Përgjithshëm për këtë periudhe raportimi ka qene ne 115 seanca te komisioneve.
Në ndërkohë, në të njëjtën periudhe kemi pranuar 31 projektligje dhe projekt udhëzime si dhe 37 dokumente te ndryshme zyrtare për dhënien e komenteve dhe rekomandimeve përkitazi me ato drafte.

Të paraqitura në formë tabelore janë aktivitetet e zhvilluara dhe të realizuara:

| Raporti i Divizionit për Legjislacion dhe Këshilla Juridike për periudhën janar-dhjetor / 2019 | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Aktivitetet e Divizionit | Kërkesat nga zyrat regjionale dhe njësitë tjera brenda Administratës Tatimore | | | Pjesëmarrja e zyrtareve ne grupe te ndryshme punuese | | Pjesëmarrja e zyrtareve ne takime zyrtare dhe komisione te ndryshme | | Komentimi i ligjeve, akteve nënligjore dhe dokumenteve tjera zyrtare | | |
| | Kërkesat për interpretime ligjore | Kërkesat për këshilla/opinione ligjore | Përgjigjeje ne kërkesa për sqarime dhe informata tjera | Pjesëmarrja ne grupe punues jashtë ATK-se | Pjesëmarrja ne grupe punuese brenda ATK-se | Ofrimi i mbështetjes juridike ne takime zyrtare | Komisione te ndryshme | Komentimi i ligjeve, akteve nënligjore tjera | Komentimi i dokumenteve t e ndryshme | Komentimi i memorandumeve dhe akteve tjera |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| Te pranuara | 131 | 55 | 124 | 44 | 90 | 188 | 115 | 31 | 37 | 9 |
| Te realizuara | 130 | 55 | 123 | 44 | 90 | 188 | 115 | 31 | 37 | 9 |
| Ne proces | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| TOTALI | 131 | 55 | 124 | 44 | 90 | 188 | 115 | 31 | 37 | 9 |

Tabela 31: Aktivitetet e realizuara nga divizioni për Legjislacion dhe Këshilla Juridike
Burimi: Raporti nga shërbimet juridike

## Përfaqësimet Ligjore[8]

Divizioni për Përfaqësime dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional (DPBN), konsideron se plani i punës për ketë periudhë është realizuar me sukses, ku është arritur që ATK të përfaqësohet në mënyrë të drejt në të gjitha nivelet procedurave gjyqësore, duke filluar në Gjykatat Themelore, Gjykatën e Apelit, Gjykatën Supreme, Dhomën e Posaçme, prokurorit themelore etj.
Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, në kuadër të autorizimeve, DPBN ka zhvilluar dhe realizuar aktivitete si në vijim:
- Kallëzime penale të paraqitur ndaj personave të dyshuar për shmangie nga tatimi, keqpërdorim të autorizimeve në ekonomi dhe organizim të bixhozit të kundërligjshëm është 24, vlerësim për regjionin në mungesë të fakteve janë 8;
- Gjatë kësaj periudhe kemi përfaqësuar ATK-së në 380 seanca gjyqësore në Gjykatat Themelore, në Gjykatën e Apelit dhe përmbaruesit privat dhe 38 seanca ne DA-ve.
- Padi të pranuara ndaj vendimeve te DA-ve janë 225, ku për secilën kemi dhanë përgjigje për gjykatën;

[8] Detaje mbi të gjitha ndjekjet penale për vepër penale në fushën e tatimeve në bazë të Ligjit 03/L-222, respektivisht Nenit 8 paragrafi 8.6. (shtojca nr.13)

- Kemi pranuar 27 ekspertiza financiare nga gjykata lidhur me vendimet e DA-ve, kurse jemi kundërpërgjigj për secilën prej tyre;

Ankesat e paraqitura nga ATK ndaj aktgjykimeve te Gjykatave Themelores dhe asaj të Apelit janë 9;

- Përgjigje me parashtresa për Gjykatën Themelore dhe Gjykatën e Apelit kemi dhanë për 160 raste;
- Padi te parashtruara ndaj aktvendimeve të KPMSHCK për inicimin e konfliktit administrativ janë 1;
- Aktvendimeve të pranuara nga prokuroria janë 24, ku jemi përgjigjur sipas kërkesave ligjore;
- Aktvendimeve të pranuara nga gjykatat janë 127, ku jemi përgjigjur sipas kërkesave ligjore;
- Aktgjykime të pranuara nga Gjykata Themelore janë 228, ku jemi përgjigjur sipas kërkesave ligjore;
- Aktgjykime të pranuara nga Gjykata e Apelit janë 45, ku jemi përgjigjur sipas kërkesave ligjore në të gjitha këto aktgjykime;
- Aktgjykime të pranuara nga Gjykata Supreme – Dhoma e Posaçme janë 79, ku jemi përgjigjur sipas kërkesave ligjore në të gjitha këto aktgjykime;

- Gjatë kësaj periudhe kemi lëshuar 60 opinione ligjore lidhur me aktgjykimet dhe aktvendimet e pranuara dhe 129 përgjigje të ndryshme për regjionet, policinë, prokurorinë, gjykatat, Avokaturën Shtetërore dhe institucionet tjera relevante.
- Pjesëmarrja në Komisionin e Ankesave në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës.
- Pjesëmarrja në Komitetin Drejtues për Rishikimin Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit.
- Pjesëmarrja në Grupin Punues lidhur me hartimin e Udhëzuesit të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Aktivitetet e zhvilluara dhe të realizuara sipas dosjeve dhe pjesëmarrjes së tyre:

| Regjionet | Dosjet e pranuara nga Zyrat Regjionale dhe veprimet e Zyrës Ligjore lidhur me dosjet | | | | | Përfaqësimi i ATK-së në seanca Gjyqësore dhe DA-ve | | Përgjigjet në padi, Kundërshtimi i ekspertizave, ankesat ndaj akt... të GJ.TH– Div.. Fiskal | | | Padit ndaj aktvendimeve të KPMSHCK, ankesat ndaj aktvendimeve dhe përgjigjet në parashtresat ndryshme | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Dosjet e pranuara dhe ato te bartura nga viti paraprak | Dosjet e shqyrtuara | Dosjet e pashqyrtuara | Kallëzime Penale | Vlerësim për Regjione | Divizion të Ankesave | Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe | Përgjigjeje në padi për Gjykatën Themelore - Divizioni Fiskal | Kundërshtim i Ekspertizave Financiare lidhur me vendimet | Ankesa ndaj Aktgjykimeve të Gj.TH dhe GJ. A - Divizioni Fiskal | Padi ndaj Aktvendimeve të Këshillit të Pavarur të Shërbimit Civil | Ankesat ndaj Aktvendimeve | Përgjigjet per Gjykatën |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
| DTM | - | - | - | - | - | - | 50 | 44 | 5 | 4 | - | - | - |
| Prishtina 1 | 2 | 2 | - | 2 | - | - | 59 | 36 | 4 | 1 | - | - | - |
| Prishtina 2 | 5 | 5 | | 3 | - | - | 21 | 18 | 2 | - | - | - | - |
| Prishtina 3 | - | - | - | - | - | - | 35 | 39 | 5 | - | - | - | - |
| Gjilan | 5 | 4 | 1 | 3 | 1 | - | 56 | 17 | 2 | 1 | - | - | - |
| Ferizaj | 3 | 1 | 2 | 1 | - | - | 30 | 14 | 1 | - | - | - | - |
| Prizren 1 | - | - | - | - | - | - | 25 | 13 | 2 | 2 | - | - | - |
| Prizren 2 | 11 | 8 | 3 | 6 | 2 | - | 24 | 10 | 2 | - | - | - | - |
| Gjakove | - | - | - | - | - | - | 37 | 8 | 1 | - | - | - | - |
| Peje | - | - | - | - | - | - | 27 | 7 | 2 | 1 | - | - | - |
| Mitrovice | 16 | 14 | 2 | 9 | 5 | - | 14 | 19 | 1 | - | - | - | - |
| ZQ | - | - | - | - | - | - | 7 | - | - | - | 1 | 1 | - |
| TOTALI | 42 | 34 | 8 | 24 | 8 | 38 | 380 | 225 | 27 | 9 | 1 | 1 | - |

Tabela 32: Aktivitetet e realizuara nga Divizioni për Përfaqësime dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional
Burimi: Raporti nga shërbimet juridike

Aktgjykimet, aktvendimet, ankesat dhe këshillat ligjore:

| Regjionet | Aktgjykimet, aktvendimet, urdhëresat e pranuara nga gjykatat, prokurorit dhe përmbaruesit privat dhe veprimet e ATK-së | | | | | | Ankesat ndaj AKP-së, DHPGJS, përgjigje në mbrojtje për DHPGJS | | | | | Këshillat ligjore, pjesëmarrja në grupe punuese | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Aktvendimet e Prokurorive | Aktvendimet e Gjykatave | Urdhëresat e Gjykatave | Aktgjykimet e Gjykatave Themelore | Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit | Aktgjykimet e Gjykatës Supreme | Ankesat në DH. P.GJ.S ndaj Vendimeve të AKP | Ankesat në Kolegj të DHPGJS | Përgjigjet në mbrojtje DHPGJS | Parashtesa për gjykata | Këshilla ligjore | Përgjigje në shkresa të ndryshme | Pjesëmarrja në Komisione dhe Grupe |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
| DTM | 1 | 16 | - | 30 | 10 | 6 | - | - | - | - | - | - | - |
| Prishtina 1 | 4 | 25 | - | 37 | 8 | 19 | - | - | - | - | - | - | - |
| Prishtina 2 | - | 11 | 1 | 14 | 4 | 5 | - | - | 1 | - | - | - | - |
| Prishtina 3 | - | 17 | - | 30 | 3 | 1 | - | - | - | - | - | - | - |
| Gjilan | - | 10 | - | 23 | 6 | 7 | - | - | - | - | - | - | - |
| Ferizaj | 16 | 14 | - | 15 | - | 6 | - | - | - | - | - | - | - |
| Prizren 1 | - | 9 | - | 11 | 1 | 3 | - | - | - | - | - | - | - |
| Prizren 2 | - | 9 | - | 14 | - | 12 | - | - | - | - | - | - | - |
| Gjakove | - | 1 | - | 23 | 3 | 4 | - | - | - | - | - | - | - |
| Peje | - | 5 | - | 14 | 4 | 8 | - | - | - | - | - | - | - |
| Mitrovice | 3 | 5 | 1 | 14 | 5 | 8 | - | - | 1 | - | - | - | - |
| ZQ. | - | 3 | - | 3 | 1 | - | - | - | - | - | - | - | - |
| TOTALI | 24 | 127 | 2 | 228 | 45 | 79 | - | - | 2 | 0 | 60 | 129 | 25 |

Tabela 33: **Aktivitetet e realizuara nga Divizioni për Përfaqësime dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional**
Burimi: Raporti nga shërbimet juridike

## 14. ANKESAT E TATIMPAGUESVE

Divizioni i Ankesave në periudhën Janar – Dhjetor 2019 ka zhvilluar dhe realizua aktivitetet duke u bazuar në përgjegjësit që i ka, ka pranuar gjithsej 612 ankesa, si dhe të bartura nga viti paraprak kanë qenë 62, pra gjithsej kanë qenë 674 ankesa.
Nga totali i ankesave kemi edhe ndarjen e ankesave sipas llojit të ankesave, ku për kontroll kemi:

- 35 ankesa janë të bartura nga viti 2018
- 287 ankesa janë pranua në vitin 2019
- 265 ankesa janë shqyrtua në vitin 2019
- 57 ankesa janë bartur në vitin 2020

Sa i përket ankesave në aktivitete në teren dhe vendime te gjobave të shqiptuara janë:
- 17 ankesa janë të bartura nga viti 2018
- 200 ankesa janë të pranuara në vitin 2019
- 200 ankesa janë shqyrtua në vitin 2019
- 17 ankesa janë bartur në vitin vijues 2020

Sa i përket ankesave nga Gjykata, Avokati i tatimpagueseve, për çështje të tjera janë:
- 10 ankesa të bartura nga viti 2018

- 125 ankesa janë pranuar në vitin 2019
- 122 ankesa janë shqyrtua në vitin 2019
- 13 ankesa janë bartur në vitin 2020

Nga totali i ankesave kemi këto raporte:
- 674 ankesa ne total te bartura dhe pranuara,
- 587 ankesa te shqyrtuara ,
- 417 ankesa janë kthye negativ
- 43 ankesa janë kthyer pozitiv
- 83 ankesa kemi pjesërisht
- 28 ankesa kemi skadim afati
- 12 ankesa janë ri kontroll
- 4 ankesa është pezulluar
- 87 ankesa janë në shqyrtim

## 15. KOMUNIKIM ME MEDIA DHE PUBLIKUN [9]

Gjate periudhës Janar-Dhjetor 2019, Drejtori i Përgjithshme i ATK-se ka mbajtur 27 takime me Menaxhmentin e larte, ne te cilat takime janë diskutuar temat lidhur me implemtimin planit strategjik dhe planeve operative dhe tema te tjera me interes ne qellim te arritjes se objektivave te planifikuara për ketë periudhe. Janë mbajtur 245 takime me institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe janë mbajtur 65 takime tjera me palët e jashtme dhe te brendshme sipas kërkesave. Gjate kësaj periudhe Drejtori i Përgjithshëm i ATK, ka pasur 19 paraqitje për media ne te cilat janë trajtuar temat qe kanë te bëjnë me te arriturat, sfidat dhe prioritetet e ATK-së.

Divizioni për Komunikim me Media dhe Publikun: Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 është angazhuar në vazhdimësi për implementimin e objektivave bazuar në Media Planin dhe Planin e Komunikimit të parapara në Planin Vjetor të Punës për vitin 2019, duke ndërmarrë aktivitete të shumta.
Edhe në këtë periudhë Divizioni për Komunikim me Publikun ka aranzhuar edhe pjesën e prezantimeve në media, kështu duke iniciuar intervista dhe prononcime për media-elektronike dhe të shkruara. Për periudhën raportuese ATK kanë pasur 55 paraqitje në media, në të cilat janë diskutuar tema të ndryshme të cilat ndërlidhen me aktivitetet e ATK-së, për ofrimin e shërbimeve të reja, për të arriturat dhe progresin që ATK ka shënuar gjatë kësaj periudhe.
Pasqyrimi i zhvillimeve dhe aktiviteteve të ATK-së, kanë qenë prezentë çdoherë në media, përmes komunikatave, ku janë publikuar 86 komunikata për media.

[9] Memorandumet dhe Marrëveshjet e brendshme (shtojca nr. 9 dhe 10)

Gjithsej janë kthyer 130 përgjigje për gazetar. Kryesisht me tema rreth inkasimit të hyrave, aktivitetet e lojërave te fatit, publikimi i listës se t/p borxhi, aplikimi i lirimit nga tatimet për prodhuesit, obligimet tatimore të këngëtarëve, kampanja e rimbursimit, obligimet tatimore për kriptovalutat etj.
Zyra për Komunikim gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar fushata mediale, përmes publikimeve të njoftimeve për tatimpaguesit në gazetat e përditshme.
Janë publikuar 29 njoftime/ shpjegimet për tatimpagues, si dhe shtatë njoftime të tjera, të dedikuara tatimpaguesve të sektorit të ndërtimtarisë!
Të gjitha njoftimet që jenë publikuar kanë dal nga plani vjetor i komunikimit me tatimpagues.

Kampanja sensibilizuese: ATK, nga muaji Qershor në bashkëpunim me FMN, ka filluar implementimin e Projektit "Përmbushja në Sektorin e Ndërtimtarisë", ku deri me tani kemi publikuar shtat (7) njoftime për tatimpaguesit e këtij sektori, të cilat janë publikuar në gazetat ditore, web-faqe, facebook zyrtar të ATK-së, si dhe secilin njoftimi e kemi përcjell tek adresa elektronike të tatimpaguesve me veprimtari ndërtimore (sipas Kodit NACE Rev.2).

Organizimi i konferencave për media: Kemi organizuar 5 konferenca për media, me qëllim të shpalosjes së aktiviteteve të ATK, një konferencë është organizuar me rastin e 19 vjetorit të ATK-së, si dhe tjetra është mbajtur me qellim të prezantimit të zhvillimeve të ATK-se ndër vite, me rastin e 11 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës. Dhe konferenca lidhur me takimin e përbashkët me donatoret dhe palët e interesi. Si dhe konferencën për media lidhur me prezantimin e raportit të punës për periudhën Janar-Qershor 2019. Ndërsa, në dhjetor kemi mbajtur konferencë për media lidhur me aktivitete e zhvilluara për mbledhjen e borxheve.

Plani i Integritetit të ATK-së: Në bashkëpunim me USAID kemi organizuar 4 tryeza për diskutime publike rreth hartimit të Planit të Integritetit të ATK-së. Diskutimet kanë qenë të ndara për kontabilistë, donator, palë të interesit si dhe institucionet publike.

Multimedia:Mirëmbajtja e rrjetet sociale: Divizioni për Komunikim me Media është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe popullimin me informacione të ueb-faqes www.atk-ks.oreg facebook-ut atk-ks.org, si dhe SharePoint.

Spotet televizive: Është përfunduar spoti televiziv, përmes së cilit informohen tatimpaguesit për rolin e ZGJONA-së. Aktualisht spoti është duke u transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës. Spoti në fjalë është mbështetur financiarisht nga GIZ-i.

Divizioni për Komunikim me Media ka iniciuar realizimin edhe të një spoti tjetër i cili ka të bëjë me kampanje e nisur për sensibilizimin e tatimpaguesve të sektorit të ndërtimtarisë, ku ATK së bashku me FMN-në kanë hartuar "Planin për Përmirësimin e Përmbushjes në Sektorin e Ndërtimtarisë 2019-2021", ku përmes këtij plani ATK do të kryejë aktivitete intensive me qëllim të identifikimit të personave, të cilët nuk përmbushin detyrimet e tyre sipas legjislacionit tatimor.

Po ashtu, Divizioni për Komunikim me Publikun, është duke planifikuar që të zhvilloj një vegël në web-faqen e ATK-së, përmes së cilës do të ketë mundësi të intensifikimi të komunikimit me tatimpagues dhe qytetarë. Kjo vegël do të quhet pyetësorë dhe anketë, e cila do të bëjë matjen e perceptimit të publikut-tatimpaguesve ndaj ATK-së dhe shërbimeve ndaj tyre.

## 16. MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Marrëveshjet Ndërkombëtare për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD)-Gjatë periudhës raportuese lidhur me METD, nga ekipi negociator i themeluar me vendim të Ministrit të Financave, janë mbajtur 13 takime. Gjatë periudhës raportuese është arritur që të hartohen draft METD në mes të Kosovës dhe Irlandës dhe në mes të Kosovës dhe Italisë, në mes të Kosovës dhe Jordanisë. Gjatë periudhës raportuese është përfunduar procesi i negocimit të marrëveshjeve, me Irlandën, Italinë, Portugalinë dhe Holandën.

Në Janar 2019, kanë filluar të zbatohen METD të Kosovës me Austrinë, me Zvicrën. Ndërsa gjatë periudhës raportuese kanë hyrë në fuqi METD, mes Kosovës dhe Maltës; mes Kosovës dhe Luksemburgut. Kosova aktualisht ka në fuqi 15 METD.

Gjatë periudhës raportuese, janë trajtuar 25 pyetje lidhur me zbatimin e METD. Janë lëshuar gjithsej 367 Certifikata të Rezidencës

Në fushën e këmbimit të informatave tatimore në zbatim të METD, janë trajtuar gjithsej 21 kërkesa për shkëmbim të informatave tatimore me autoritetet tatimore përkatëse.

Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar format e reja për shkëmbimin e informatave tatimore bazuar në METD. Këto forma janë sipas standardeve ndërkombëtare dhe do të përdoren si për komunikimin brenda ATK ashtu edhe për shkëmbimin e informatave me autoritetet e tjera tatimore.

Asistenca Teknike nga Donatorët

Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 14 takime konsultative me GIZ, për organizimin e asistencave teknike në vijim. Gjithashtu gjatë periudhës raportuese nga GIZ janë organizuar programe të trajnimeve në fushën e shkathtësive të buta në komunikim, ndërtimi i raporteve në grup dhe menaxhimi i ndryshimeve. Gjithashtu është pranuar asistencë lidhur me ngritjen e kapaciteteve në fushën e kanaleve të komunikimit me tatimpagues dhe staf, në zbatimin e reformës në ndërtimtari.

Lidhur me ngritjen e kapaciteteve në fushën e menaxhimit të rrezikut të përmbushjes, është realizuar asistenca teknike me ekspertë nga Administrata Tatimore e Munihut.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të stafit në fushën e Zgjona II për vepra penale, është realizuar asistenca teknike me ekspertë përkrahur nga GIZ, ku përveç takimeve me Departamentet relevante është mbajtur edhe punëtoria për zyrtaret e ZGJONA.

Gjatë periudhës raportuese, në suaza të bashkëpunimit me GIZ, janë realizuar 2 ekspertiza lidhur me zbatimin e Projektit të Përmirësimit të Përmbushjes në Sektorin e Ndërtimtarisë, me theks komponenta e komunikimit dhe hartimit të dokumenteve strategjike.

Në Mars, është realizuar misioni e Bankës Botërore me temë, përkrahja e ATK në zbatimin e reformës. Qëllimi i misionit ka qenë diskutimi për zhvillimet aktuale në ATK, planet e ATK në zbatimin e reformës dhe fushat ku BB mund ta asistojë ATK në zbatimin e reformës institucionale.

Gjatë periudhës raportuese është realizuar edhe takimi fillestar i lancimit të programit të bashkëpunimit mes ATK-GIZ –BB, lidhur me përmirësimin e përmbushjes vullnetare përmes ndikimit në sjelljen e tatimpaguesve. Gjithashtu në Tetor 2019 është realizuar misioni i cili ka pasur për qëllim

prezantimin e qasjes e cila është vazhdim i matjes së përmbushjes vullnetare tatimore përmes ndikimit në sjelljen e tatimpaguesve dhe në fund ndikimi i gjithë kësaj në zvogëlimin e ekonomisë jo-formale.
Në Mars 2019, është mbajtur takimi me përfaqësues nga Departamenti për Çështje Fiskale në FMN, lidhur me fushat e përkrahjes në të ardhmen. ATK gjatë vitit 2019, ka përfituar asistencë teknike në fushën e organizimit institucional, modernizimit të teknikave të kontrollit, menaxhimit të rrezikut të përmbushjes tatimore, menaxhimit të performancës institucionale.
Gjatë periudhës raportuese janë realizuar asistenca teknike nga FMN lidhur me modernizimin e teknikave të kontrollit tatimor, menaxhimin e rrezikut të përmbushjes, konsolidimin e mbledhjes së detyrueshme. Asistencat teknike kanë zgjatë nga 2 javë.
Në Prill, 2019 janë realizuar misionet e FMN të ngritjes së kapaciteteve në fushën e Përmirësimit të Përmbushjes në Sektorin e Ndërtimtarisë dhe në Modernizimin e Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.
Në Korrik dhe Tetor është realizuar asistenca teknike në menaxhimin e rrezikut të përmbushjes.
Në Prill, Shtator dhe Nëntor 2019 është realizuar asistenca teknike nga FMN e cila ishte vazhdim i përmirësimit të funksionit të kontrollit.
Në Korrik dhe Dhjetor është realizuar asistenca teknike në hartimin dhe implementimin e Projektit të Konsolidimit të Mbledhjes së Detyrueshme.

Gjatë periudhës raportuese ATK ka përcaktuar aktivitetet ku do të bashkëpunoj me USAID. Lidhur me këtë është hartuar një program i aktiviteteve të cilat kanë filluar së zbatuari në Shtator 2019. Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019 në bashkëpunim me USAID është hartuar draft plani i integritetit të ATK, i cili ka rezultuar nga një sërë bashkëpunimi me palët e treta. Gjithashtu në bashkëpunim me USAID është punuar edhe në avancimin e veglave të Teknologjisë Informative të fushës së shërbimeve ndaj tatimpaguesve.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar 3 misione të ekspertizës në fushën e Transferimit të Çmimit nga programi “Tax Inspectors Without Borders” i përkrahur nga OECD.

Sa i përket asistencave nga TAIEX, është mbajtur asistenca në Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe në fushën e trajtimit të Ngarkesës së Kundërt në TVSh. Ndërsa, në proces janë 3 kërkesa për asistencë teknike, Transferimi i Çmimit, Marrëveshjet Tatimore Ndërkombëtare dhe Kthimi i TVSh për Turistë, të cilat janë në pritje për përgjigje nga Komisioni Evropian.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar-Në Shkurt 2019, përfaqësues nga ATK kanë qenë pjesëmarrës në konferencën për ngritjen e kapaciteteve në administrata tatimore e cila është mbajtur në OECD – Paris. Në konferencë, janë prezantuar përfitimet që ATK ka pasur nga programi TIWB dhe nga seminaret e organizuara në fushën tatuarjes ndërkombëtare dhe praktikave të administratave tatimore
Gjithashtu gjatë periudhës raportuese, përfaqësues nga ATK kanë realizuar takim me Drejtorinë e Tatimeve në Tiranë, me qëllim të fillimit të punës dhe ndërmarrjes së aktiviteteve për zbatimin e Marrëveshjes për Themelimin e Qendrës së Përbashkët në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.
Në Maj 2019, zyrtarë të ATK kanë qenë pjesë e sesionit informues të klimës investive në Zvicër, ku janë prezantuar lehtësirat tatimore e të bërit biznes në Kosovë dhe lehtësirat tatimore.

Gjatë periudhës raportuese zyrtarë nga ATK kanë qenë pjesë e Samitit vjetor të organizuar në Beçiç me temë, Stabiliteti financiar dhe monetar në rajon në një klimë të rritjes së ngadalshme në Eurozonë. Gjithashtu në Qershor 2019 në Lubjane është mbajtur takimi vjetor për koordinimin e përkrahjes ndërkombëtare në administratat tatimore dhe financat publike, të Evropës Juglindore.
Gjatë periudhës raportuese është realizuar vizita studimore në Qendrën e Thirrjeve në Administratën e të Hyrave në Turqi me qëllim të marrjes së praktikave në fushën e menaxhimit të performancës në qendrën e thirrjeve.
Gjithashtu është realizuar vizita studimore në Agjencinë e të hyrave dhe doganës në Mbretërinë e Bashkuar të Anglisë, me qëllim të marrjes së praktikave në fushën e luftimit të evazionit tatimor dhe shmangies tatimore. Kjo vizitë është realizuar në kuadër të programit të bashkëpunimit mes ATK dhe Ambasadës së Britanisë së Madhe.
Në Nëntor 2019, zyrtarë të ATK kanë marrë pjesë në punëtorinë me temë "Arti për bashkëpunim me Donatorë", i mbajtur në Gjermani.
Në Nëntor 2019, zyrtarë të ATK ishin pjesë në një vizitë zyrtare për festën e "Ditës së Tatimpaguesve" e cila u mbajte në Shkup, Maqedoni.
Në Nëntor 2019, zyrtarë të ATK ishin pjesë e sesionit informues  me temë " Klima e investimeve në Kosovë", i cili u mbajt në Gjermani.
Në Dhjetor 2019, zyrtarë të ATK ishin pjesë e punëtorisë së organizuar në Gjermani me temë "Komunikimi i organizatave dhe Institucionet Publike".
Në Dhjetor 2019, përfaqësues nga ATK kanë marrë pjesë në takimin e organizuar nga Konsulata e Kosovës në Zvicër ku janë prezantuar elementet e marrëveshjes për eliminimin e tatimit të dyfishtë në mes të Kosovës dhe Zvicrës.

## Integrimet Evropiane

Gjatë periudhës raportuese janë përcaktuar objektivat dhe aktivitetet që ATK është përgjegjëse për realizimin e tyre gjatë vitit 2019, në kuadër të Planit të Veprimit të Punës së Ministrisë së Financave 2019 dhe Planin Vjetor të Punës së Qeverisë së Kosovës 2019.
Është raportuar për progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Agjendës së Reformës Evropiane, ku pjesët për të cilat raportohet janë procesi i fiskalizimit, të hyrat, realizimi i vizitave dhe kontrolleve tatimore, zbatimi i Strategjisë për Luftimin e Ekonomisë Joformale.
Lidhur me Planin kombëtar për Zbatimin e MSA-së, është përgatitur raporti 9 mujor për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të këtij plani.
Gjithashtu gjatë periudhës raportuese është përgatitur raporti 6 mujor për vitin 2018 për Strategjinë e Reformës në Menaxhimin e Financave Publike dhe është prezantuar para palëve të interesit dhe organizatave të huaja.
Sa i përket Inputit të Komisionit Evropian lidhur me raportin për vendin janë përgatitur 3 raporte. Gjithashtu është përgatitur raporti për DPSA  për Ministrinë e Financave Prill 2018-Maj 2019. Në Qershor 2019 është publikuar Raporti për Kosovën për vitin 2019 ku janë identifikuar të gjeturat dhe rekomandimet të cilat duhet të adresohen për zbatim.
Në qershor 2019 është mbajtur takimi i Nën-Komitetit për Tregti, Industri, Doganë dhe Tatime me DG TAXUD nga Komisioni Evropian ku është dakorduar për konkluzionet të cilat do të zbatohen për 1 vit.

Është mbajt takimi me Zyrën e BE në Kosovë, lidhur me diskutimin e fushave ku ATK do të përkrahet nga KE dhe ku ka nevojë që të përkrahet. Përkrahja do të jetë në formë të trajnimeve dhe vizitave studimore në fushën e trajtimit tatimor të sektorit financiar, kontrolli tatimor në transferimin e çmimit, tatuarja ndërkombëtare.

Të tjera- Strategjia për Reformë në Menaxhimin e Financave Publike, lidhur me zbatimin e kësaj Strategjie, janë mbajt gjithsej 13 takime ku është raportuar për progresin e arritur për vitin 2019 në zbatimin e objektivave të parapara në këtë Strategji, që janë përgjegjësi e ATK dhe është punuar në rishikimin e Pasaportës së Indikatorëve. Janë përgatitur 19 shkresa për udhëtime zyrtare!

Në kuadër te Programit te Shkëmbimit te Përgjithshëm CEPOL është dërguar ftesa për shkëmbim te përvojave tatimore ne Turqi, ndërsa për Programin e Shkëmbimit CEPOL-Projekti WBFI janë dërguar ftesa për shkëmbim te përvojave tatimore ne këto vende Shqipëri, Maqedoni, Slloveni, Mal te Zi, Estoni, Letoni, Francë, Kroaci, Hungari, Gjeorgji dhe Portugali.

Në kuadër të Programit të Shkëmbimit CEPOL-Projekti WBFI, janë aprovuar 8 aplikacione për zyrtarë të ATK-së, ku katër zyrtarë të ATK-së kanë shkëmbyer përvojat tatimore me katër zyrtarë nga administrata tatimore në Letoni, dy zyrtarë të ATK-së kanë shkëmbyer përvojat tatimore me dy zyrtarë nga administrata tatimore në Estoni dhe dy zyrtarë të tjerë do ti shkëmbejnë përvojat tatimore me dy zyrtarë nga administrata tatimore e Polonisë.

Në kuadër të trajnimeve të Programit te Shkëmbimit CEPOL për vitin 2019, kemi pranuar ftesën për trajnimin “Cash Collectors in Money Laundering” që është mbajtur më 20-24 Maj 2019 në Institutin e Parisit për Studime Politike. Sipas kërkesës, është caktuar një zyrtar nga DHTI-ATK dhe ka marrë pjesë në këtë trajnim. Në muajin Gusht kemi pranuar ftesën për trajnimin “Financial Investigations related to corruption“ që është mbajtur më 4-8 Nëntor 2019 në Shkup-Maqedoni dhe kanë marrë pjesë dy zyrtarë nga DHTI-ATK.

Në muajin Shtator është pranuar ftesa e radhës për trajnimin “Missing-trader intra-community fraud“ që është mbajtur me datë 25-29 Nëntor në Budapest-Hungari dhe ka marrë pjesë një zyrtar nga DHTI-ATK.
Gjatë periudhës raportuese është dërguar shkresa për Komisionin Evropian lidhur me vullnetin e ATK për të qenë pjesëmarrëse në programin FISCALIS 2020 dhe është pranuar përgjigje pozitive.

## 17. PJESËMARRJE NË GRUPE PUNUESE

- Grupi punues për modifikimin e formularëve tatimor PD dhe CD.
- Grupi punues për hartimin e Projektligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat.
- Ekipi Negociator për METD, shqyrtimi i draft Marrëveshjes për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) në mes të Republikës së Kosovës dhe Portugalisë.
- Grupi punues për të bërit biznes.

- Grupi Punues për hartimin e dokumentit mbi proceset e regjistrimit dhe ndërveprimin e sistemeve të TI të ATK dhe ARBK.
- Ekipi Negociator për METD – Zhvillimi i negociatave për METD në mes të Republikës së Kosovës dhe Irlandës .
- Grupi Punues për hartimin e Vendimit Shpjegues Publik për Aplikimin e Ngarkesës së Kundërt të TVSH.
- Ekipin Negociator për METD, shqyrtimi i draft METD në mes të Republikës së Italisë dhe Republikës së Kosovës,  në Romë, Itali;
- Grupi Punues për automatizimin e kritereve për kategorizimin e bizneseve në modulin e rimbursimit
- Grupi Punues për Migrimin e shënimeve nga ARBK me rastin e lëshimit të NUI për bizneset ekzistuese.
- Grupi Punues për Projektin e përmbushjes në sektorin e Ndërtimtarisë, mbështetur nga FMN.
- Grupi Punues për hartimin e Ligjit për Sigurimet Shëndetësore.
- Grupi Punues "KAOE" për hartimin e Vendimit Shpjegues Publik sipas të cilit bëhet përcaktimi i kërkesave funksionale dhe teknike për të mundësuar funksionalizimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale dhe Sistemeve Fiskale në Kosovë.
- Grupi Punues për Teknika të Kontrollit.
- Grupi Punues lidhur me krijimin dhe funksionimin e ndërlidhjes në mes të Sistemit të Informimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe Sistemit të informimit të ATK-së;
- Grupin punues, me përfaqësuesit e Kompanisë UBO të angazhuar nga GIZ për Anketën e Tatimpaguesve 2019, hartimi i pyetësorit për anketim;
- Ekipi negociator për hartimin e METD në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Irlandës, në Dublin, Irlandë;
- Ekipi "Shkëmbimi i përvojave me shtetet tjera" vizitë në Itali .
- Grupi punues për "Manualin e kontrollit".
- Grupi punues në bashkëpunim me FMN për përgatitjen e projektit në sektorin e hotelerisë dhe restoranteve;
- Grupin punues për hartimin e Udhëzuesit për Teknikat e Kontrollit për Aksionarët;
- Grupi Punues për Konsolidimin e Mbledhjes së Detyrueshme;
- Grupi Punues për hartimin e Planit të Integritetit të ATK-së;
- Grupi Punues për hartimin e Koncept dokumentit për njohjen e investimeve të Diasporës në Kosovë.

# 18. SHTOJCAT

1. LISTA E TË PUNËSUARVE NË ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS
2. LISTA E PUNËTORËVE TË PENSIONUAR
3. LISTA E STUDENTEVE PRAKTIKANTË SIPAS MARRËVESHJES ME MINISTRINË E FINANCAVE DHE UNIVERSITETIN E PRISHTINËS 2019 (MF-UP-ATK)
4. LISTA E STUDENTËVE QË KANË NDJEKUR PRAKTIKËN NË ATK
5. VENDIMET SHPJEGUESE PUBLIKE 2019
   - 5.1. NR. 01/2019 – PËR TRAJTIMIN TATIMOR TË IMPORTEVE DHE FURNIZIMEVE KUR FINANCOHEN APO BASHKFINANCOHEN DREJTPËRDREJTË NGA KOMISIONI EVROPIAN
   - 5.2. NR. 02/2019 – PËR TRAJTIMIN TATIMOR TË KONTRATAVE AFATGJATË NDËRTIMORE
   - 5.3. NR. 03/2019 – DETYRIMI PËR TË PAGUAR TVSH-NÊ PËR FURNIZIMIN E SHËRBIMEVE NË LËMIN E NDËRTIMIT – APLIKIMI I NGARKESËS SË KUNDËRT
6. LIGJI NR.06/L-105 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE
7. FLETPALOSJET PER TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE (TAK)
8. FLETPALOSJET PER TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE (TAP)
9. FLETPALOSJET PËR TATIMIN MBI VLEREN E SHTUAR (TVSH)
10. MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI 2019 NDËRMJET ATK – FONDI PER SIGURIME SHENDETSORE
11. MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NDËRMJET MZHE PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA E KOSOVËS PËR OFIÇIENCË TË ENERGJISË DHE ATK-SË
12. LISTA E BIZNESEVE QË KANË PËRFITUAR LIRIME PËR TVSH NË IMPORTIM TË LËNDËS SË PARË DHE PAJISJEVE TË TI
13. DETAJE MBI TË GJITHA NDJEKJET PENALE PËR VEPËR PENALE NË FUSHËN E TATIMEVE NË BAZË TË LIGJIT 03/L-222, RESPEKTIVISHT NENIT 8 PARAGRAFI 8.6
14. LISTA E ANKESAVE TË TATIMPAGUESVE NË VITIN 2019
15. LISTA E RIMBURSIMEVE PËR VITIN 2019

# ORGANIZIMI TERRITORIAL SIPAS ATK-së




Adresa: Këndi i rrugëve Bill Klinton & Dëshmorët e Kombit
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel & Fax: +381 (0)38 200 250 17 & 200 250 07
Email: info@atk-ks.org; Web: www.atk-ks.org